



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:275023

Datë: 20.12.2021

Numri i dokumentit: 02531658

AA.nr.1016/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Rami Kuqi dhe Gani Avdiu anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit M.F., nga fshati ..., Komuna e Klinës, të cilin e përfaqëson me autorizim A. K., avokat në Malishevë, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Komisioni Qeveritar për Verifikimin dhe Njohjen e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me bazë juridike njohje e statusit të veteranit të Luftës së UÇK-së, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2249/18, të datës 26.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.12.2021, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit M.F., e datës 16.11.2021, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2249/18, të datës 26.10.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e ankimuar me ankesë, të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, është hedhë poshtë padia e paditësit, M.F., me nën shenjë A.nr.2249/18, e parashtruar me dt.17.09.2018, si e parregullt.

Kundër këtij aktvendimi, paditësi ka ushtruar ankesë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e

Apelit, të aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e paditësit M.F., të anuloj aktvendimin A.nr.2249/2018, të datës 26.10.2021 dhe lënda të kthehet në rigjykim për vendosje në mënyrë meritore.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, padinë e paditësit dhe pretendimet në ankesë dhe pas vlerësimit edhe të shkresave të tjera të lëndës, si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë në procedurë të shqyrtimit paraprak të padisë, më datë 15.12.2020, e ka detyruar paditësin që në afat prej 8 ditësh, të bëjë plotësimin e saj, në kuptimin objektiv, në atë mënyrë që të përcaktoj saktë cilin akt të të paditurës e konteston me padi apo të dorëzoj të gjitha provat me të cilat dëshmon se i njëjti i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative para se ti drejtohet gjykatës me këtë padi. Përkatësisht ti bëjë të ditur gjykatës se mbi bazën e nenit 13 apo 14 të Ligjit për Konfliktet Administrative kishte inicuar konfliktin administrativ.

Paditësi me dt.09.02.2021 ka dorëzuar në gjykatë parashtrësën për plotësimin e padisë, nëpërmes të cilës ka vazhduar të kërkoj nga gjykata që ti njihet statusi i veteranit, ngase nga e paditura nuk ka pranuar kurrëfar akti administrativ për njohjen e statusit të veteranit. Me anë të kësaj parashtrëse paditësi lenë të kuptohet se konfliktin e ka filluar konform nenit 14 të LKA (heshtjes administrative), mirëpo nuk kishte argumentuar këtë fakt me dorëzimin e dëshmisë së Kërkesës së përsëritur, të dërguar në adresë të të paditurës, ashtu sic parashihet në bazë të nenit 29.1 LKA. Andaj gjykata ka vlerësuar se me një plotësim të tillë paditësi i nuk i ka evituar të metat e padisë dhe në kuptim të nenit 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padinë e të njëjtit e hudhi si të parregullt.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 29 par.1 dhe 3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrativ, i cili nen përcakton se: “1. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejshëm prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t’i është refuzuar ankesa. 3. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim”, Kolegji gjeti se paditësi pas kalimit të afatit për nxjerrjen e vendimit të organit të shkallës së parë, ka parashtruar ankesë në Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranit të UÇK-së me datë 30.03.2015, ndërsa e paditura me datë 12.09.2018 ka lëshuar një vërtetim me të cilin e ka njoftuar paditësin se është në listën e të refuzuarave nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Integruarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ndërsa paditësi pas pranimit të këtij vërtetimi ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë me të cilën ka kërkuar që ti njihet statusi i Veteranit të Luftës së UÇK-së nga dita e aplikimit për këtë status si dhe të drejtat tjera të cilat i takojnë me ligjin nr.04/L-261. Mirëpo paditësi nuk ka ushtruar ankesë ndaj këtij vërtetimi, por drejt ka ushtruar

padi në gjykatë pa i shterur mjetet e brendshme juridike. Nga të cekurat më lart gjykata gjen se paditësi nuk ka shterur mjetet juridike para organeve administrative në afat ligjor e që kërkohen në rastin kur nuk merret përgjigja në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, siç është kërkesa e përsëritur, që pastaj të mund t'i drejtohet gjykatës në konfliktin administrativ me padi.

Paditësi me parashtresën për plotësimin e padisë të datës 09.02.2021, ka kërkuar që ti njihet statusi i veteranit, dhe të detyrohet e paditura ti paguaj paditësit të gjitha pagat siq i takojnë sipas ligjit të veteranëve të Luftës nga momenti i aplikimit të paditësit e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore sipas këtij ligji. Andaj Kolegji vlerëson se paditësi nuk ka shterur mjetet juridike para organeve administrative në afat ligjor e që kërkohen në rastin kur nuk merret përgjigja në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, siç është kërkesa e përsëritur në afat prej 7 ditësh, që pastaj të mund t'i drejtohet gjykatës në konfliktin administrativ me padi.

Theksimet në ankesë të cekura si më lartë dhe të tjerat, kolegji i shqyrtoi në baza ligjore, dhe i vlerëson se janë të pa bazuara, sepse paditësi në asnjë fazë të procedurës nuk ofron dëshmi që ka vepruar në baza ligjore sipas dispozitave të LKA-së, të cekura më lartë për fillimin e procedurës gjyqësore të konfliktit administrativ, ashtu si parashihen sipas dispozitave të LPA-së në procedurë administrative, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë, e hedhë poshtë padinë si të parakohshme si në vështrim të nenit 34 par.1.1 dhe nenit 29 par.1 dhe 2 të LKA-së.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA dhe neni 209, pika.b) i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AA.nr.1016/2021, me datë 16.12.2021

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi